



Prishtinë: 04. 02. 2014

Ref: KSEL. 01. 2014

KOMISIONI SHQYRTUES

Komisioni Shqyrtues në përbërje të:

1. Ylber Aliu, Kryesues
2. Mejrem Çernobregu, Anëtare
3. Erver Zhariku, Anëtar

KOMISIONI SHQYRTUES	
Emri i Komisionit	04/4
Emri i Komisionit	KSH
Emri i Komisionit	06.02.2014

Në çështjen e ankesës së:

Ndërmarrjes Publike Komunale, "Lypeteni", Kaçanik (me tutje: NPK, "Lypeteni", Kaçanik) ankesë e bërë me datë: 09. 01. 2014, me Nr 4 / 1.

Kundër vendimit të:

Zyrës Rregullatore për Ujësjetllës dhe Kanalizim (me tutje: ZRRUK), datë: 31. 12. 2013, Nr 566 / 3, për gjobitjen e NPK, "Lypeteni", Kaçanik në shumën prej 20. 000 Euro (njëzetmijë euro) për operim pa licencë të shërbimit.

BAZA JURIDIKE

1. Neni 34 i Ligjit për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetllësit, Kanalizimit dhe të Mbeturinave (me tutje: Ligji Nr. 03/L-086).

PËRMBËLEDHJA E FAKTEVE

2. Përmas vendimit të datës: 31. 12. 2013, me Nr 566 / 3, ZRRUK konstaton se, "NPK 'Lypeteni' - Kaçanik gjobitet në shumën prej 20. 0000 Euro (njëzetmijë euro), me që ka bërë shkelje nga neni 32. 1 nënparagrafi (a) të Ligjit Nr 03 / L - 086 dhe nenit 4 të Rregullës për Licencimin e Ofruesve të Shërbimit të Ujësjetllësit, Kanalizimit dhe të Furnizimit të Ujit me shumicë në Kosovë (R - 01 / U & K) - ofrimi i shërbimeve të ujësjetllësit dhe kanalizimit pa pasur licencë të shërbimit".
3. Në vendimin e ZRRUK-it thuhet se, "Operimi i NPK 'Lypeteni' - Kaçanik pa pasur Licencë të Shërbimit, për ZRRUK tani më është i paligjshëm në pajtim me përgjegjësit që ka për sektorin e ujësjetllësit dhe kanalizimit, udhëhiqetur në nenin 1. 4 të Ligjit Nr 03 / L - 086, shërbime këto njëqift jetike për qytetarët e Kosovës". Po ashtu në

arsyetim ceket se, "Besoja dhe shpresajmi se Ministria për Zhvillim Ekonomik (MZHE) do të veprtoj në pajtim me përgjegjësit që ka me nenin 11. 3 të Ligjit për Ndërmarrjet dhe Platësimin e Ligjit Nr 03 / L - 087 për Ndërmarrjet Publike (Ligji Nr 04 / L - 111) ku do të zgjidhet statusi i jashtë juridik definitivisht. Nga të cekurat në lartë ZRRUK është i shtrënguar të marrë Vendim si në dispozitivin".

4. Këtë vendim ZRRUK e nxjerr duke u bazuar: I. Nenin 33. 2 të Ligjit Nr 03 / L - 086 mbi Ndërmarrjet e Rregulloëts së UNMIK-ut 2004 / 49 mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe Mbeturinjave (Ligji Nr 03 / L - 086). II. Përgjigja në paralajmërimin e proceduar më: 11. 12. 2013, me Nr 07, Nr 16 - 31265 nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente nga Komuna e Kaçanikut. III. Bazuar në ushtrimin e veprimtarisë të NKP "Lypeteni" - Kaçanik, ofrimi i shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe kohëzgjatjen e ofrimit të këtyre shërbimeve jetike për qytetarët e Komunës së Kaçanikut.
5. Ndaj këtij vendimi të ZRRUK-ut, NPK "Lypeteni" me datë: 09. 01. 2014, me Nr 4 / 1, ka parashtruar ankesë. Në ankesë NKP "Lypeteni" sqaron se "Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente ka bërë kërkesën me Nr 16 - 7657 / 2013 të datës 05. 03. 2013, pranë Ministrisë të Zhvillimit Ekonomik për zyrtarizimin - lejen e ndërmarrjes publike të NKP "Lypeteni" lëshu që kjo ndërmarrje është në pritje për zyrtarizimin e kësaj ndërmarrje sipas ligjit në fuqi të datës: 20. 03. 2012 me Nr 04 / L - 11 si dhe rregulloes 11 - 802, 10 - 13 mbesim me shpresë se kërkesa jonë pranë këtij organi të shpërthet".

PREZANTIMI I ARGUMENTEVE

6. Komisioni Shqyrtues në takimin e mbajtur me datë: 20. 01. 2014, sipas nenit 34, pika 34. 4, të Ligjit Nr 03/L-086, ka vendosur të ofrojë mundësinë përfaqësuesit të ZRRUK-it dhe NPK, "Lypeteni", në Kaçanik, në Komisionin Shqyrtues të dëgjojë qëndrimet e tyre lidhur me vendimin dhe ankesën.
7. Në takimin e mbajtur me datë: 20. 01. 2014, përfaqësuesi i ZRRUK-ut, paraqiti se, "I kemi njoftuar të gjitha palët e interesit për aktivitetin legal të ndërmarrjes, por prapa asgjë dhe asnjë veprim për parandalim dhe ndërmarrja ka vazhduar me aktivitetet e saj. Andaj na si zyre nuk kemi dashur në të marrim përgjegjësin dhe ju kemi dërguar paralajmërimin me datën 18. 06. 2012".
8. Në anë tjetër, përfaqësuesi i NPK, "Lypeteni" Kaçanik paraqiti se, "Nga momenti i shkëputjes tonë nga KUIR Bifurkacioni ne ju kemi raportuar në baza mujore të gjitha institucioneve për veprimtarinë tonë si SHUKOS-it, Kuvendit Komunal, Ministrinë e Punëve të Lohal". Po ashtu, përfaqësuesi i NPK, "Lypeteni" Kaçanik sqaron se, "Në kemi bërë kërkesën dhe i kemi dërguar të gjitha dokumentet në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik për legalizim, licencim të ndërmarrjes, por ende nuk kemi marrë asnjë përgjigje". Gjithashtu, përfaqësuesi i NPK, "Lypeteni" potencoi faktin që, kompania ka numrin fiskal të biznesit të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe

Industrië dhe cilësinë e ujit të verifikuar nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik.

9. Përfaqësuesi i ZRUKK-it, korstatoi se,

"Ata mund të lëshojnë vetëm certifikatë e jo Licenca. Sa i përket IKSHIPK-së, ata lëshojnë dhe nënshkruajnë kontrata ofruese të shërbimit pa kërkuar nga ta licencën, dhe në këtu është si boshllëku".

VLERËSIMI

10. Komisioni shqyrtues vlerëson se ankesa e NPK, "Lypeteni", Kaçanik është bërë brenda afatit kohor ligjor prej 15 ditë pune dhe si e tillë është e pranueshme.
11. Komisioni shqyrtues ka gjetur se, Kuvendi i Komunës Kaçanik, me datë: 27. 02. 2009, ka marrë vendim për shpërbërjen e njësisë komunale të ujit dhe kanalizimit nga ndërmarrja publike KRUK, "Bifurkacioni", të Ferizaj, dhe kthimin e statusit si Ndërmarrje Publike Komunale ashtu sikurse e ka pasur deri në vitin 2003.
12. Komisioni shqyrtues ka gjetur se, prej datës: 27. 02. 2009, NKP, "Lypeteni", Kaçanik ka vepruar ndaras nga KRUK, "Bifurkacioni", Ferizaj, si ndërmarrje publike komunale, por deri me datë: 03. 02. 2012, ka figuruar në zonën e shërbimit të Certifikatës së Licencës së Shërbimit të KRUK, "Bifurkacioni", Ferizaj, edhe komuna e Kaçanik-ut.
13. Prej datës: 03. 02. 2012 deri me datë: 04. 02. 2014, NPK, "Lypeteni", Kaçanik, nuk ka pasur Certifikatë të Licencës së Shërbimit të lëshuar nga ZRRUK. Për këtë periudhë kohore, NPK, "Lypeteni", Kaçanik, ka ofruar shërbime publike të ujit pa Certifikatë të Licencës së Shërbimit nga ZRRUK-u.
14. Arsyetimi i NKP, "Lypeteni", Kaçanik është se ka qenë në pritje të themelimit si ndërmarrje publike komunale, si kusht paraprak për të aplikuar për marrjen e Certifikatës së Licencës së Shërbimit nga ZRRUK-u.
15. Komisioni shqyrtues ka gjetur se, me datë: 20. 04. 2012 është miratuar Ligji për ndryshim dhe plotësimin e ligjit Nr 03 / L - 087 për ndërmarrjet publike, i cili ligj me datë: 30. 05. 2012 është shpallur në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.
16. Komisioni shqyrtues ka gjetur se, duke vepruar pa Certifikatë të Licencës së Shërbimit, prej datës: 03. 02. 2012 deri me datë: 04. 02. 2014, NKP, "Lypeteni", Kaçanik, ka vepruar në kundërshtim të plotë me nenin 3 Ligji Nr. 03/L-086, ku përcaktohet se:
"Asnjë person nuk mund të ofrojë shërbime në Kosovë pa lejen për shërbime përkatëse".
17. Dhe me nenin 1. 4 të Ligji Nr. 03/L-086, ku përcaktohen se:

"Rregullatori është përgjegjës për rregullimin e veprimtarive të ofruesve të shërbimeve në pronësi shtetërore dhe publike të ushqejllësit, kafshëzimit dhe mbetarinave në Kosovë. Rregullatori merr vendime të pazvarura gjatë asistimit të përgjegjësive në bazë dispozitave të këtij Ligji ose çfarëdo rregulloje ose ligji në fuqi dhe çfarëdo urdhërese administrative, udhëzimi administrativ ose vendimi tjetër i cili mund të nxirret në vijim".

18. Po ashtu Rregulla R - 01 për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza dhe të Fumizimit të Ujit me Shumicë në Kosovë, konkretisht neni 6, përcakton se:

"Të gjitha Ndërmarrjet Publike në Kosovë që tani ofrojnë Shërbime të Ujit dhe të Ujërave të Zeza duhet të aplikojnë te Rregullatori për Licencë të Shërbimit sipas dispozitave të kësaj Rregulle".

19. Prandaj, dhe duke pasur parasysh këto fakte, Komisioni shqyrtues në takimin e mbajtur me datë: 04. 02. 2014:

VENDOS

1. Mbetet në fuqi vendimi i ZRRUK-ut Nr 566 / 3, me datë: 31. 12. 2013.
2. Hedhet poshtë ankesa e NKP, "Lypeteni", Kaçanik, Nr 4 /1, me datë: 09. 01. 2014.
3. Obligohet NKP, "Lypeteni", Kaçanik, të veprojë në pajtim me nenin 33. 3 (b) të Ligjit Nr 03/L-086.
4. Obligohet NKP, "Lypeteni", Kaçanik, të veprojë në pajtim me nenin 32. 4 të Ligjit Nr 03/L-086.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e lëshimit.

Këshillë juridike: Në bazë të nenit 35 të Ligjit Nr. 03/L-086, palët e pakënaqura me këtë vendim mund të parashitrojnë ankese në Gjykatën Kompetente për shqyrtim brenda një (1) muaji nga data kur ofruesit të shërbimeve i është dorëzuar me shkrim vendimi përkatës nga Komisioni Shqyrtues.

Kryesuesi i Komisionit Shqyrtues:

Ylber Aliu

